



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3.5.2023

Nr: 435

Ora: 17:00

VENDIM

PËR

**LIRIM DHE EMËRIM TË SEKRETARIT DHE ANËTARËVE NË DISA KZAZ, PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Partia e Lirisë kanë kërkuar lirim dhe emërim të anëtarëve në disa KZAZ.

Partia Socialiste e Shqipërisë, me shkresën nr. 4533 prot., datë 03.05.2023 ka kërkuar lirimin nga detyra të anëtarit të KZAZ nr. 66, Bashkia Berat dhe zëvendësimin e tij.

Partia e Lirisë, me shkresën nr. 4565 prot., datë 03.05.2023, ka kërkuar lirimin nga detyra të anëtarit të KZAZ nr. 07, Bashkia Pukë, dhe anëtarit të KZAZ nr. 32, Bashkia Tiranë dhe zëvendësimet e tyre.

Partia Demokratike e Shqipërisë, me shkresën nr. 3583 prot., datë 07.04.2023, ka kërkuar lirimin nga detyra të sekretarit të KZAZ nr. 32, Bashkia Tiranë dhe zëvendësimin e tij.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

Data: 3.5.2023 Nr: 435
Ora: 17:00



“Për lirim dhe emërim të sekretarit dhe anëtarëve në disa KZAZ, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Lirimin nga detyra të sekretarit dhe anëtarëve në disa KZAZ, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Emërimin e sekretarit dhe anëtarëve në disa KZAZ, sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Lidhja 1

Nr	Qarku	KZAZ	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti	Pozicioni
1	Shkodër	07	Fatos	Kadri	Syla	PL	Anëtar
2	Tiranë	32	Shkëlqim	Shaban	Ajazi	PL	Anëtar
3	Tiranë	32	Diamant	Idriz	Parllaku	PD	Sekretar
4	Berat	66	Miguel	Guxim	Hasantari	PS	Anëtar



Lidhja 2

Nr	Qarku	KZAZ	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti	Pozicioni
1	Shkodër	07	Astrit	Agim	Kuçi	PL	Anëtar
2	Tiranë	32	Silvana	Andrea	Sata	PL	Anëtar
3	Tiranë	32	Elvis	Ali	Gjuzi	PD	Sekretar
4	Berat	66	Hasan	Fadil	Dervishi	PS	Anëtar

